



A.nr.2023/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi- Bajraktari, kryetare, Eshref Shabani dhe Ardita Haxhnikaj-Demi, anëtarë, me Atdhe Gashi, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.2023/2025, të datës 12.12.2025, të parashtruar nga ankuesit: J.D-D, A.O dhe B.SH-S, të cilët sipas autorizimit i përfaqëson ankuesja J.D-D, nga Prishtina, kundër organit të punësimit Komuna e Prishtinës, në çështjen juridike “*kompensim material*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, nenin 16, paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180, dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 01.04.2026, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.2023/2025, e datës 12.12.2025, e parashtruar nga ankuesit: J.D-D, A.O dhe B.SH-S.

A r s y e t i m

Nëpunësit civil, J.D-D, A.O dhe B.SH-S (*tutje referuar* ankuesit), me datë 12.12.2025, kanë parashtruar ankesë me numër protokolli 7859/2025 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Përgjigjes në ankesë të datës 08.12.2025, përmes të cilit pretendojnë se nuk i’ u është llogaritur saktë paga dhe kompensimi në mënyrë retroaktive.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*tutje referuar* Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 24.12.2025, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Komuna e Prishtinës, ndërsa, kjo e fundit, më datë 29.12.2025, ka përcjell përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat referuar çështjes në procedurë.

Tutje, Kryetari i Këshillit, pas pranimit të kërkesës së Kryetares së Kolegjit për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, me Vendim me numër protokolli 341/2026, të datës 21.01.2026, ka shtyrë afatin për vendosje të ankesës me numër A.nr.2023/2025, të parashtruar nga ankuesit edhe për dhjetë (10) ditë pune

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (*tutje referuar* Kolegji i Këshillit), ka **administruar këto prova**: Ankesën me numër protokolli 7859/2025, të datës 12.12.2025, të parashtruar nga ankuesve në Këshill; Autorizimin; Përgjigjen në ankesë të datës 08.12.2025; Vendimin me Nr.14-

030/01-130882/25 të datës 28.08.2025; Kërkesën me numër protokolli 14-117/01-178513/25 të datës 25.11.2025; Vendimin A.nr.1096/2025 të datës 07.07.2025; Kopjen e letërnjoftimet të ankuesve; Kërkesën për përgjigjen në ankesë të datës 24.12.2025; Përgjigjen në ankesë të datës 29.12.2025; Akt emërimit me Nr.01-112-1079 të datës 29.11.2024; Akt emërimit me Nr.01-112-1079 të datës 01.01.2024, me përshkrimin e detyrave të punës; Listat e pagave të ankuesve të vitit 2025; Akt emërimit me Nr.01-112-806 të datës 29.11.2024;

Kolegji i Këshillit, pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka gjetur se ankesa është e **pabazuar, sepse:**

Bazuar në të dhënat zyrtare që Këshilli, posedon rezulton se ankuesit janë të punësuar në Komunën e Prishtinës, ashtu që ankuesja J.D-D. sipas Akt Emërimit 01nr.112-1092 të datës 01.02.2017, është emëruar në pozitën Zyrtare Certifikuese me koeficient tetë (8) të pagës, ankuesi A.O sipas Akt Emërimit me Nr. 01-112-806 të datës 01.10.2022 është emëruar Zyrtar Certifikues me koeficient tetë (8) të pagës si dhe ankuesja B.-SH-S, sipas Akt Emërimit me Nr. 01-112-1079 të datës 01.01.2024, është emëruar në pozitën Zyrtare Certifikuese me koeficient 7.3.

Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore e Komunës së Prishtinës bazuar në nenin 102 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, më datë 29.11.2024 ka lëshuar akt emërimi të reja për ankuesit për pozitat Zyrtar i Lartë Certifikues, me Kategori dhe Klasë Profesional 1, GJ25, dhe koeficient 5.7, dhe si rrjedhojë ankuesit nga muaji dhjetor 2024, kanë realizuar paga sipas koeficientit 5.7.

Ankuesit më datë 14.05.2025, kanë parashtruar kërkesën me numër 14-070/01-66060/25, tek Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore e Komunës së Prishtinës, për njohje të shtesës tranzitore ndërmjet pagës së pozitës së kategorisë së ulët dhe asaj profesional 1, siç e kishin realizuar para akt emërimeve të datës 29.11.2024 gjegjësisht pagën sipas kategorisë së ulët drejtuese.

Ndërsa, në përgjigje të kërkesës së ankuesve, Sektori i Burimeve Njerëzore të Komunës së Prishtinës më datë 16.05.2025, ka nxjerr Vendimin me numër 14-070/01-66060/25, me të cilin ka refuzuar kërkesën e ankuesve me arsyetimin se para hyrjes në fuqi të Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publikë, ankuesit nuk kanë realizuar pagë më të madhe por kanë realizuar sipas koeficienteve të vjetër, ndërsa sipas katalogut të vendeve të punës pozita Zyrtar i lartë Certifikues është renditur në kuadër të grupit të ekonomisë, dhe sipas shtojcës 10.7 të Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publikë koeficient për këtë pozitë është 5.7.

Ankuesit kundër Vendimit me numër 14-070/01-66060/25, të datës 26.05.2025, të Sektorit të Burimeve Njerëzore të Komunës së Prishtinës, kishin parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke pretenduar se para lëshimit të akteve të reja të emërimeve të datës 29.11.2024 kishin realizuar koeficient të pagës 7.3, të cilin koeficient e kishin përfutur dhe kjo ishte vendosur sipas Aktgjykimit Nr. KO79.23 të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, ndërsa, kjo e drejtë i është mohuar sipas akt emërimeve të datës 29.11.2024. Kërkojnë që të aprovohet ankesa, të obligohet Komuna e Prishtinës që t'ua njohë shtesën tranzitore dhe atë nga muaji dhjetor 2024 deri në zbatim të vendimit.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, përmes Vendimit A.nr.1096/2025 të datës 07.07.2025, ka aprovuar si të bazuar ankesën e ankuesve të datës 09.06.2025, ashtu që ka anuluar Vendimin me numër 14-070/01-66060/25, të datës 26.05.2025, të Sektorit të Burimeve Njerëzore të

Komunës së Prishtinës, duke obliguar me këtë rast Kryetarin e Komunës dhe Udhëheqësin e Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Komunën e Prishtinës, të ndërmarrin veprimet e nevojshme administrative, ashtu që ankuesve t'i njihet e drejta në shtesë tranzitore dhe t'ju realizohet kompensimi i difference së papaguar të shtesës tranzitore nga muaji dhjetor 2024 e deri në zbatimin e këtij vendimi.

Kryetari i Komunës së Prishtinës, në zbatim të Vendimit A.nr.1096/2025 të datës 07.07.2025, të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 28.08.2025 ka nxjerrë Vendimin me Nr.14-030/01-30882/25, përmes të cilit akt ankuesve i' u ka njohur kompensimin në mënyrë retroaktive të diferencës së papaguar të shtesës tranzitore nga muaji dhjetor 2024 e tutje, respektivisht deri në arritjen e koeficientit të pagës 7.3.

Ankuesit, me datë 25.11.2025 kanë parashtruar kërkesën me numër protokolli 14-117/01-178513/25 pranë Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Komunën e Prishtinës, për llogaritjen e saktë të pagave dhe kompensimit retroaktiv të tyre, duke theksuar se me vendimin e Qeverisë nga janari i vitit 2025 koeficienti është rritur për 0.5 njësi dhe nga korriku për 0.5 njësi tjera, në atë mënyrë që të gjithë të punësuarit do të kenë rritje pagash nga 55 E nga janari 2025, dhe 110 E nga korriku. Ndërsa, gjatë zbatimit të KPMSHCK-së, pretendojnë nuk është bërë llogaritje e drejtë, ashtu që nuk është llogaritur ashtu siç duhej: $7.3 \times 110 E = 803 E$, shtuar kësaj rritjen $110 E = 913 E$. Rrjedhimisht, ankuesit pretendojnë se gjatë zbatimit të këtij vendimi janë dëmtuar nga 176 E në muaj, ngase kompensimi sipas Vendimit të Kryetarit të Kryeqytetit, është bërë mbi vlerën e shtesës tranzitore deri në vlerën e koeficientit 7.3, kurse çështja e rritjes së bërë nga ana e Qeverisë, nuk është llogaritur, duke shtuar se kompensimi është dashur të bëhej pa diskriminim dhe në mënyrë të njëjtë me të gjithë të punësuarit tjerë në nivel shteti.

Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Komunën e Prishtinës, në përgjigjen në ankesë të datës 08.12.2025, ka theksuar se kalkulimi dhe kompensimi i shtesës tranzitore është bërë duke u bazuar në Vendimin A.nr.1096/2025 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Vendimin e Komunës së Prishtinës me Nr.14-030/01-130882/25, si dhe në përputhje me nenin 41 të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik.

Ankuesit, kundër përgjigjes së Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Komunën e Prishtinës, me datë 12.12.2025 kanë parashtruar ankesë në Këshill, me pretendimet e njëjta ankimore sikurse në kërkesën e lartë theksuar, rrjedhimisht, kërkojnë që të bëhet kompensimi në mënyrë retroaktive dhe vazhdimi i shtesës ashtu siç parashihet me ligjet në fuqi.

Lidhur me shqyrtimin e pretendimeve ankimore të ankuesit, Kolegji i Këshillit ju referua dispozitave të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, i zbatueshëm nga data 05.02.2023, përkatësisht nenin 2, paragrafi 1, në lidhje me fushëveprimin ku parashihet se: *''1. Ky ligj zbatohet për të punësuarat/it në sektorin publik pagat e të cilave/ëve financohen nga dhe përmes buxhetit të shtetit, 2. Rregullat dhe kushtet për përcaktimin e pagës të të punësuarave/ve në sektorin publik janë ekskluzivisht rregullim i këtij ligji dhe mund të rregullohen edhe me akte të tjera nënligjore, vetëm kur parashihet shprehimisht nga ky ligj''*, dhe nenin 14, paragrafi 3, të këtij ligji ku përcaktohet se: *3. Klasifikimi i një pozite të caktuar të shërbimit civil, bëhet në bazë të rregullave të vlerësimit dhe klasifikimit të pozitave të punës, sipas dispozitave për klasifikimin e pozitave të shërbimit civil, në pajtim me legjislacionin në fuqi për zyrtarët publik, dhe rrjedhimisht, referuar këtij përcaktimi ligjor, Kolegji i Këshillit konstatoi se paga bazë e*

nëpunësit civil përcaktohet sipas klasës së pagës, përkatësisht koeficientit, të cilit i përket pozita e punës, e klasifikuar në shtojcën Nr.10 të Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, kurse klasifikimi i një pozite të caktuar të shërbimit civil, bëhet në pajtim me legjislacionin në fuqi për zyrtarët publik dhe rregulloren e aplikueshme për klasifikimin e vendeve të punës në Shërbimin Civil.

Lidhur me klasifikimin e pozitës së punës Zyrtar Certifikues, Kolegji thekson faktin së Rregullorja (QRK) Nr. 10/2022 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, në fuqi nga data 30.12.2022 deri më 27.02.2024, më shtojcën Nr.1/5 kishte përcaktuar se: *“Pavarësisht përcaktimeve të kësaj kategorie, për qëllim të klasifikimit pozita e certifikuesit konsiderohet si pozitë ekuivalente me drejtuesin e ultë në institucionin përkatës. Detyrat dhe përgjegjësitë e certifikuesit përcaktohen me legjislacionin relevant në fuqi”*, dhe rrjedhimisht mbi këtë bazë, me hyrjen në fuqi të Ligjit për Pagat në Sektorin Publik (02.05.2023), dhe në zbatim të Vendimit të Qeverisë Nr. 04/128 të datës 16.02.2023 për ekuivalencën e sistemit të vjetër me sistemin e ri të klasifikimit të koeficienteve me qëllim të llogaritjes së pagës bazë për të punësuarit në sektorin publik, ankuesja J.D.D dhe ankues A.O, kanë realizuar pagë më koeficient 7.3, gjegjësisht me klasa Gj1-7.30/800.30.

Tutje, më hyrjen në fuqi të Rregullores (QRK) Nr. 06/2024 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil (datë 28.02.2024), pozita e Zyrtarit Certifikues nuk kategorizohet si pozitë ekuivalent me drejtuesit e ulët të institucionit përkatës, rrjedhimisht referuar Katalogut të Vendeve të Punës i miratuar me Vendimin nr. 08/226, datë 23.10.2024, të Qeverisë së Kosovës, pozita Zyrtar Certifikues, klasifikohet si pozitë e kategorisë profesionale, klasa profesional 1, ndërsa, paga dhe komponent e saj përcaktohen në pajtim Ligjin Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, mirëpo edhe përkundër kësaj e duke u bazuar në Aktgjykimin për rastin Nr.KO79/23, e Gjykatës Kushtetuese, lidhur me vlerësimin e kushtetutshmërisë së Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, Kolegji i Këshillit, dhe duke qenë së ankuesit në J.D-D dhe A.O, para hyrjes në fuqi të këtij ligji kanë fituar të drejtën në pagë e barasvlershme me pagën e udhëheqësit të ulët (udhëheqësit të sektorit në komuna) ndërsa, ankuesja B.Sh-S edhe pse ka themeluar marrëdhënie pune në pozitën Zyrtare Certifikuese pas hyrjes në fuqi të ligjit përkatës të pagave, atëherë ankuesit në J.D-D dhe A.O, gëzojnë të drejtën në paga në nivel të drejtuesit të sektorit edhe pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, duke aplikuar shtesën tranzitore në koeficient të pagës të njohur sipas këtij ligji, ndërsa, ankuesja B.SH.S gëzon këtë të drejtë vetëm nga muaji shkurt 2024, e tutje.

Ndërsa, sipas nenit 32 dhe 33 të Ligjit mbi ndarjet buxhetore të buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2025, të miratuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, është përcaktuar se:

- (Neni 32 Vlera e koeficientit të pagës, shtesat dhe kompensimet) 1. *Vlera monetare e koeficientit për Ligjin për Pagat në Sektorin Publik është njëqind e dhjetë (110 €) euro.* 2. *Autorizohet Ministri që sipas nevojës me vendim të bëjë ngritjen e tavanit të shtesave dhe kompensimeve të përcaktuara me Ligjin për Pagat në Sektorin Publik, për vitin fiskal 2025.*

- (Neni 33 Rritja e njësive së koeficientit të pagës) 1. *Rritet koeficienti i pagës për një (1) njësi për të gjitha klasat e pozitave sipas Shtojcave 1 - 15 të Ligjit nr. 08/L-196 të Pagave në Sektorin Publik.* 2. *Rritja sipas paragrafit 1 të këtij neni, aplikohet në dy faza, me rritje prej zero pikë pesë (0.5) njësi të koeficientit duke filluar nga muaji janar 2025, ndërsa rritja tjetër prej zero pikë pesë njësi (0.5) aplikohet nga muaji korrik 2025.*

Andaj, bazuar në arsyetimin e lartë theksuar dhe dispozitat ligjore, Kolegji i Këshillit, konstaton se pretendimet ankimore të ankuesve janë të pabazuara ligjërisht, për faktin e lartë theksuar se pozita Zyrtar i Lartë Certifikues, me hyrjen në fuqi të Rregullores (QRK) Nr. 06/2024 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil (datë 28.02.2024) dhe Katalogut të Vendeve të Punës i miratuar me Vendimin nr.08/226, datë 23.10.2024, të Qeverisë së Kosovës, nuk parashihet me koeficient 7.3 apo se nuk kategorizohet si pozitë e nivelit të ulët drejtues, përkatësisht e njëjta klasifikohet si pozitë e kategorisë profesionale, klasa profesional 1, ndaj kësisoj edhe rritja e njësisë së koeficientit të pagës sipas nenit 33 të Ligjit mbi ndarjet buxhetore të buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2025, nga 7.3 në 8.3 e më tej edhe rritja e vlerës shtesë tranzitore në rastin konkret nuk mund të aplikohet, mirëpo, e njëjta rritje e njësisë së koeficienteve aplikohet vetëm për pozitat të cilat janë klasifikuar sipas rregullores në fuqi dhe të parapara me katalogun përkatës, sikurse në rastin e ankuesve ku të njëjtat për pozitat të cilat mbajnë sipas akt emërimeve të datës 29.11.2024, për pozitat e punës Zyrtar i Lartë Certifikues, Klasa Profesional 1 GJ25, koeficienti 5.7, sipas listave të pagave për vitin 2025, përveç kompensimeve të diferencës së shtesës tranzitore në mënyrë retroaktive të realizuar në muajin tetor, nga muaji janar i këtij vitit rezulton se kanë përfituar edhe rritjen prej zero pikë pesë (0.5) në njësinë e koeficienteve të pagës bazë, dhe atë dy herë brenda këtij vitit, nga rrjedhë se ankuesit gabimisht kanë kërkuar dhe interpretuar aplikimin e rritjes së njësisë së koeficienteve, për faktin se të njëjtat këtë drejtë e kanë realizuar sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Kështu që pas analizimit dhe vlerësimit të shkresave të lëndës dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe nenin 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS*Lënda me numër A.nr.2023/2025***Atdhe GASHI**

Procesmbajtës**Malsore GASHI-BAJRAKTARI**

Kryetare e Kolegjit**Vendimi i dërgohet:**

- *Përfaqësueses së autorizuar të ankuesve, ankueses J.D-D;*
- *Kryetarit dhe Menaxherit të Burimeve Njerëzore në Komunën e Prishtinës; dhe*
- *Arkivit të KPMSHCK-së.*